



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 22 janar 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi kërkesën e Kadri Veselit për lirim të përkohshëm

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹, në përputhje me nenin 41(2), (6) dhe (12) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, Kadri Veseli (“z. Veseli” ose “i akuzuari”) u arrestua në përputhje me vendimin (“Vendim për arrestim dhe paraburgim”)² dhe fletarrestimin e lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,³ me kërkesë⁴ të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (përkatësisht “ZPS” dhe “Kërkesa e ZPS-së”), dhe pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij.⁵

2. Më 15 dhjetor 2020, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja”) bëri me dije se do të dorëzonte një kërkesë për lirim të përkohshëm dhe propozoi afate për parashtrimet në lidhje me të prej palëve, përfshirë një seancë lidhur me kërkesën.⁶

3. Më 16 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera: (i) rrëzoi kërkesat e Mbrojtjes për mbajtjen e seancave lidhur me vazhdimin e paraburgimit ose

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni publik i redaktuar i vendimit për kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi*, 26 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00027/A03/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00005/CONF/RED2, Prokurori i Specializuar, *Versioni i dytë konfidencial i redaktuar i ‘kërkesës për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me të’, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 15 dhjetor 2020, konfidencial; shih edhe F00005/RED, Prokurori i Specializuar, Versioni i redaktuar publik i ‘kërkesës për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me të’, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 17 nëntor 2020, publik, me shtojcat 1-3, publike.*

⁵ KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version publik i redaktuar i vendimit për konfirmimin e Aktakuzës për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin* (“Vendimi i konfirmimit”), 26 tetor 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00145, Mbrojtja e z. Veseli, *Parashtrimet e Mbrojtjes së Kadri Veselit – Konferenca mbi ecurinë e çështjes*, 15 dhjetor 2020, publike, para. 6-7.

lirimin e të akuzuarit; dhe (ii) i kërkoi ZPS-së që deri më 4 janar 2021, t'i përgjigjej kërkesës për lirim të përkohshëm të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Veseli dhe ky i fundit të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij deri më 11 janar 2021.⁷

4. Më 17 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Veseli dorëzoi kërkesën për lirim të përkohshëm ("kërkesa") dhe përsëriti kërkesën për seancë në lidhje me këtë pikë.⁸

5. Më 4 janar 2021, ZPS-ja iu përgjigj kërkesës ("përgjigjja").⁹

6. Më 5 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi numrin e lejuar prej 6.000 fjalësh për të gjitha kundërpërgjigjet e Mbrojtjes.¹⁰

7. Më 8 janar 2021, Mbrojtja kërkoi që kërkesa të riklasifikohej si publike ("kërkesa për riklasifikim").¹¹

8. Më 13 janar 2021, pas vendimit për zgjatjen e afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjes,¹² Mbrojtja iu kundërpërgjigj përgjigjes ("kundërpërgjigjja").¹³

⁷ KSC-BC-2020-06, F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit dhe ndryshimin e afatit për mocionet paraprake* ("Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit"), 16 dhjetor 2020, publik, para. 30(a), (c)-(d).

⁸ KSC-BC-2020-06, F00151, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë për lirim të përkohshëm të Kadri Veselit*, 17 dhjetor 2020, konfidenciale, me shtojcat 1-7, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00161, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Kadri Veseli*, 4 janar 2021, konfidenciale, me shtojcën 1, konfidenciale; shih edhe F00161/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar publik i 'Përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Kadri Veseli'*, 15 janar 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00162, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për shtimin e numrit të fjalëve në kundërpërgjigje*, 5 janar 2021, publik, para. 12(a)-(b).

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00169, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë për riklasifikimin e "Kërkesës për lirim të përkohshëm të Kadri Veselit me shtojcat 1-7"*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00151, datë 17 dhjetor 2020, 8 janar 2021, publike.

¹² KSC-BC-2020-06, F00171, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për zgjatjen e afatit*, 11 janar 2021, konfidencial dhe ex parte.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00174, Mbrojtja e z. Veseli, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë lidhur me kërkesën për lirim të përkohshëm të Kadri Veselit*, 13 janar 2021, publike, me shtojcat 1-12, publike.

II. PARASHTRIME

9. Mbrojtja parashtron se: (i) nuk ka baza për të arritur në përfundimin se z. Veseli rrezikon të arratiset; (ii) nuk ka arsye të artikulueshme për arritur në përfundimin se z. Veseli do të ndërhyjë te dëshmitarët apo do të pengojë zhvillimin e procesit të drejtësisë; dhe (iii) nuk ka bazë tjetër të mëvetësishme për të pretenduar se ekziston rrezik për kryerjen e veprave të tjera penale.¹⁴ Mbi të gjitha, edhe sikur Gjykatësi i Procedurës Paraprake të konstatonte se këto arsye të artikulueshme ekzistojnë, mbajtja në paraburgim është joproporcionale duke pasur parasysh kompetencën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vendosur kushte për lirim dhe për kohshëm dhe kohëzgjatjen e pritshme që nga paraqitja e parë e z. Veseli deri në datën e nisjes së gjyqit.¹⁵

10. ZPS-ja e kundërshton kërkesën me argumentin se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, sikurse ishte konstatuar më parë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁶ Më tej ZPS-ja pretendon se vetëm paraburgimi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") është i mjaftueshëm për të trajtuar këto rreziqe.¹⁷

11. Mbrojtja u kundërpërgjigjet tre prej argumenteve të trajtuara nga ZPS-ja në përgjigjen e saj.¹⁸ Gjithashtu, Mbrojtja e përsërit kërkesën për mbajtjen e një seance, nëse ka kundërshtime për ndonjë prej dëshmive të marra nga dëshmitarët në mbështetje të kundërpërgjigjes së saj dhe vetëm në lidhje me ato kundërshtime, për të mundësuar që dëshmitarët të merren në pyetje personalisht.¹⁹

¹⁴ Kërkesa, para. 4, 6-51.

¹⁵ Kërkesa, para. 5, 59-69.

¹⁶ Kërkesa, para. 1, 5-43.

¹⁷ Kërkesa, para. 1, 44-46.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 1-72.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 73.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Neni 41(2) i Ligjit parasheh që çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë të paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e Specializuara.

13. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se: (i) ekziston rreziku i arratisjes; (ii) se ai ose ajo do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë veprë penale, ose rrethanat specifike tregojnë se ai do të pengojë ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, palët e dëmtuara ose bashkëfajtorët; ose (iii) natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale të tij, sjellja e tij në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat ai jeton, ose rrethanat e tjera personale tregojnë se ekziston rreziku që ai të përsërisë veprën penale, të përfundojë ndonjë vepër penale të mbetur në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë.

14. Në bazë të rregullës 57(2) të Rregullores, pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose me kërkesë të të akuzuarit ose Prokurorit të Specializuar ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

15. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se krahas mbajtjes në paraburgim mund të urdhërohen edhe masat e mëposhtme për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedimit penal: fletëthirrja, fletarrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të

caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në një vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse. Sipas rregullës 56(5) të Rregullores, një panel mund të caktojë kushte që i gjykon të përshtatshme për lirimin, për të garantuar praninë e personit të paraburgosur.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDET E ZBATUESHME

16. Mbrojtja parashtroi se, duke qenë se z. Veseli mbahet aktualisht në paraburgim në bazë të vendimit që u lëshua *ex parte* për arrestimin dhe paraburgimin dhe fletarrestimit përkatës, nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkohet të veprojë *de novo* dhe të shqyrtojë rishtas ekzistencën e faktorëve që përligjin paraburgimin bazuar në materialet e paraqitura nga palët ²⁰. Mbrojtja arsyeton më tej se, në përputhje me kornizën ligjore të DHS-së, e ka ZPS-ja detyrimin për të përcaktuar kriteret e artikulueshme që janë paraparë në nenin 41(6) të Ligjit, ndërsa i akuzuari nuk ka detyrim prove lidhur me lirimin e përkohshëm.²¹ Për më tepër Mbrojtja parashtroi se, për të vërtetuar ekzistencën e arsyeve të artikulueshme që tregojnë se i akuzuari konkret, rasti i të cilit po shqyrtohet, përbën një rrezik të caktuar në rast se do të lirohej përkohësisht, atëherë ZPS-ja duhet t'i mbështesë akuzat kundër të akuzuarit në fjalë mbi baza të forta faktike.²²

17. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të "bindet" se kriteret e nenit 41(6) të Ligjit janë përmbushur.²³ Ajo që vlerësohet është mundësia, e jo pashmangshmëria e ngjarjeve të tilla në të ardhmen, dhe nëse plotësohen këto kushte, atëherë personi duhet të vazhdojë të qëndrojë në paraburgim.²⁴ Më tej ZPS-ja

²⁰ Kërkesa, para. 53.

²¹ Kërkesa, para. 55-59 dhe referencat e përfshira aty.

²² Kërkesa, para. 14-16 dhe referencat e përfshira aty.

²³ Kërkesa, para. 2-3.

²⁴ Kërkesa para. 2 dhe referencat e përfshira aty.

parashtron se, në rastin aktual, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë në vendimin për arrestimin dhe paraburgimin se ishin plotësuar kriteret sipas nenit 41(6) të Ligjit; si rrjedhojë, në pajtim me Kërkesën dhe rregullën 57(2) të Rregullores, çështja që duhet shqyrtuar është rishikimi i atij vendimi.²⁵ ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se vlerësimi individual nuk përjashton marrjen parasysh të kontekstit apo të veprimeve të tjerëve, dhe se pozita e një të akuzuari apo kontaktet e tij, rrjetet e përkrahjes dhe rrethanat e përbashkëta që vlejné për më shumë se një të akuzuar, janë me rëndësi për vlerësimin e individualizuar dhe në përputhje me të.²⁶

18. Mbrojtja përgjigjet se atmosfera e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve nuk mjafton për të përligjur mbajtjen në paraburgim, përveç rasteve kur ZPS-ja mund ta lidhë individin e akuzuar me ndonjë orvatje të vërtetuar për frikësimin e dëshmitarëve, dhe po aq e pamjaftueshme është edhe përmendja *in abstracto* e faktit se dëshmitari ka një rrjet përkrahës.²⁷

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, megjithëse fletarrestimi u lëshua *ex parte* pa pjesëmarrjen e Mbrojtjes në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit, , neni 41(2) i Ligjit i jep personit të paraburgosur një mundësi të hershme për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit të tij, duke përfshirë edhe arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit. Rrjedhimisht, nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkohet të shqyrtojë rishtas ekzistencën e fakteve që përligjin paraburgimin, duke mbajtur parasysh argumentet e paraqitura nga palët²⁸. Në këtë kontekst, theksohet se çdo kërkesë për lirim të përkohshëm duhet shqyrtuar në kuadër të së drejtës së personit të paraburgosur për t'u supozuar i pafajshëm.²⁹

²⁵ Përgjigjja, para. 4.

²⁶ Përgjigjja, para. 11-12.

²⁷ Kundërpërgjigjja, para. 5-6 dhe referencat e përfshira aty.

²⁸ KSC-BC-2020-07, F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt* ("Vendim i parë mbi paraburgimin e Haradinajt"), 27 tetor 2020, publik, para. 12-13.

²⁹ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit*

20. ZPS-ja ka barrën të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.³⁰

21. Për sa i takon standardit provues brenda kuptimit të nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, kur plotësohet kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që lejojnë heqjen e lirisë duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi.³¹ Në lidhje me këtë, neni 41(6)(b) i Ligjit pasqyron parimin se vazhdimi i paraburgimit të një personi mund të përligjet vetëm kur ka tregues konkretë të një kushti të njëmendtë me interes publik që peshon më shumë se e drejta për liri e personit.³² Rrjedhimisht, kur merr vendimin për vazhdimin e paraburgimit, paneli duhet të mbështetet në arsyetim konkret dhe arsye konkrete;³³ që do të thotë se duhet të konstatojë se ekzistojnë arsye specifike dhe konkrete për të besuar se i akuzuari përbën rrezik për interesin publik, i cili mund të zvogëlohet vetëm përmes vazhimit të paraburgimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se, në bazë të provave të disponueshme, arsyet e artikulueshme specifike duhet të mbështesin “besimin”³⁴ se ekziston rreziku i paraparë në cilindo nga tre nënparagrafët e nenit 41(6)(b) të Ligjit, që tregon pranimin e mundësisë, dhe jo të

të Specializuar (“Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017”), 26 prill 2017, para. 113. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-2151-Red, Appeals Chamber, [*Judgment on the Appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo Against the Decision of Trial Chamber III of 6 January 2012 Entitled “Decision on the Defence’s 28 December 2011 ‘Requête de Mise en liberté provisoire de M. Jean-Pierre Bemba Gombo’*](#), 5 March 2012, para. 40.

³⁰ DHSGJK Aktvendim, 26 prill 2017, para. 115. Ngjashëm, për shembull, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-208, Appeals Chamber, [*Judgment on the Appeal of Mr Laurent Gbagbo Against the Decision of Trial Chamber I of 8 July 2015 Entitled “Ninth Decision on the Review of Mr Laurent Gbagbo’s Detention Pursuant to Article 60\(3\) of the Statute”*](#) (“Gbagbo 8 September 2015 Appeal Judgment”), 8 September 2015, para. 36; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1019, Appeals Chamber, [*Judgment on the Appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo Against the Decision of Trial Chamber III of 28 July 2010 Entitled “Decision on the Review of the Detention of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo Pursuant to Rule 118\(2\) of the Rules of Procedure and Evidence”*](#), 19 November 2010, para. 51; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-330, Pre-Trial Chamber I, [*Decision on the Powers of the Pre-Trial Chamber to Review Proprio Motu the Pre-Trial Detention of Germain Katanga*](#), 18 March 2008, p. 7.

³¹ Neni 19.1.30 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës 2012, Ligji nr. 04/L-123 e përkufizon termin “i artikulueshëm” si: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

³² DHSGJK, Aktvendim, 26 prill 2017, para. 113.

³³ DHSGJK, Aktvendim, 26 prill 2017, para. 115.

³⁴ *Shih* pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

pashmangshmërisë së ndodhjes së tyre në të ardhmen.³⁵ Me fjalë të tjera, megjithëse dyshimi në vetvete nuk mjafton, të qenit plotësisht i sigurt nuk kërkohet.

22. Lidhur me natyrën e vlerësimit brenda kuptimit të nenit 41(6)(b) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, ndonëse përfshin një element të kompetencës diskrecionale,³⁶ vlerësimi duhet të mbështetet në faktet e çështjes dhe duhet të kryhet në bazë individuale, duke mbajtur parasysh rrethanat personale të secilit të akuzuar.³⁷ Rrjedhimisht, të njëjtët faktorë, kur zbatohen në një çështje tjetër, në lidhje me një të akuzuar tjetër, mund të rezultojnë në një përfundim të ndryshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ose mund të konsiderohen të parëndësishëm.³⁸ Gjatë vlerësimit të faktorëve përkatës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të bëjë një vlerësim të copëzuar, por duhet të peshojë të gjithë këta faktorë të marrë së bashku.³⁹ Këta faktorë mund të jenë individualë, si për shembull, natyra dhe

³⁵ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Dhoma e Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe paraburgimin* ("Vendimi i apelit të Gucatit"), 9 dhjetor 2020, publik, para. 63, 67. Shih gjithashtu Vendimi i parë mbi paraburgimin e Haradinajt, para. 18. Po ashtu, ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba Against the Decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014, Entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba"](#) ("Bemba et al. Appeal Judgment"), 11 July 2014, para. 107, 117; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-572, Appeals Chamber, [Judgment in the Appeal by Mathieu Ngudjolo of 27 March 2008 Against the Decision of Pre-Trial Chamber I on the Application of the Appellant for Interim Release](#) ("Katanga Appeal Judgment"), 9 June 2008, para. 21; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-824, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr. Thomas Lubanga Dyilo Against the Decision of Pre-Trial Chamber I Entitled "Décision sur la demande de mise en liberté provisoire de Thomas Lubanga Dyilo"](#) ("Lubanga Appeal Judgment"), 13 February 2007, para. 137.

³⁶ Vendimi i apelit të Gucatit, para. 49. Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Popovic et al.*, IT-05-88-AR65.2, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Defence Appeal of Trial Chamber Decision Denying the Provisional Release of Ljubomir Borovčanin](#) ("Borovčanin Appeal Decision"), 30 June 2006, para. 5.

³⁷ Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR65.5, Appeals Chamber, [Decision on Prosecution's Consolidated Appeal Against Decision to Provisionally Release the Accused Prlić, Stojić, Praljak, Petković and Čorić](#) ("Prlić et al. Appeal Decision"), 11 March 2008, para. 7; *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-AR65.1, Appeals Chamber, [Decision on Defence Appeal Against Trial Chamber's Decision on Sredoje Lukić's Motion for Provisional Release](#) ("Lukić Appeal Decision"), 16 April 2007, para. 7; ICC/GJPN, [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 111.

³⁸ Ngjashëm, ICTY/TPNJ, [Borovčanin Appeal Decision](#), para. 15.

³⁹ Vendimi i apelit të Gucatit, para. 61; Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Šainović and Ojdanić*, IT-99-37-AR65, Dhoma e Apelit, [Decision on Provisional Release](#) ("Šainović and Ojdanić Appeal Decision"), 30 tetor 2002, para. 6; [Prlić et al. Appeal Decision](#), para. 7; [Lukić Appeal Decision](#), para. 7; *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/08-323, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr. Jean-Pierre Bemba](#)

fushëveprimi i krimeve që pretendohet se janë kryer nga i akuzuari dhe dënimi i mundshëm me të cilin ai përballë,⁴⁰ mosha e të akuzuarit, posti ose postet e tij (të mëparshme), profesioni, lidhjet familjare, gjendja shëndetësore, pasuria, sjellja dhe deklaratat e tij,⁴¹ kontaktet dhe lidhjet ndërkombëtare,⁴² dhe ekzistenca e rrjeteve të përkrahjes të cilat mund të lehtësojnë materializimin e një rreziku.⁴³ Këta faktorë gjithashtu mund të jenë edhe kontekstualë, si për shembull, mjedisi dhe kushtet në të cilat i akuzuari jeton,⁴⁴ apo faza përkatëse e procesit që është duke u kryer.⁴⁵ Sidoqoftë, vetëm faktorët kontekstualë nuk janë të mjaftueshëm për të demonstruar ekzistencën e rrezikut. Secili faktor mund të mbështesë një apo më shumë nga arsyet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁴⁶ Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të mbajë parasysh jo vetëm faktorët përkatës ekzistues në kohën e marrjes së vendimit, por

Combo Against the Decision of Pre-Trial Chamber III Entitled "Decision on Provisional Release", 16 dhjetor 2008, para. 55; *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-970, Appeals Chamber, *Judgment on the Appeal of the Prosecutor Against the Decision of Pre-Trial Chamber II of 23 January 2015 Entitled "Decision 'Mr Bemba's Request for Provisional Release'"*, 29 May 2015, para. 27; *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-969, Dhoma e Apelit, *Judgment on the Appeals Against Pre-Trial Chamber II's Decisions Regarding Interim Release in Relation to Aimé Kilolo Musamba, Jean-Jacques Mangenda, Fidèle Babala Èandou, and Narcisse Arido and Order for Reclassification*, 29 May 2015, para. 45.

⁴⁰ Vendim i apelit të Gucatit, para. 72. Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Borovčanin Appeal Decision* para. 9, 14-15; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Appeals Chamber, *Judgment on the Appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo Against the Decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 Entitled "Decision on the 'Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo'"* ("Gbagbo Appeal Judgment"), 26 tetor 2012, para. 54; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-323, Appeals Chamber, *Judgment on the Appeal of Mr. Jean-Pierre Bemba Gombo Against the Decision of Pre-Trial Chamber III Entitled "Decision on the Request for Interim Release"*, 16 December 2008, para. 55.

⁴¹ *Shih*, ECtHR/GJEDNJ, *Gábor Nagy v. Hungary*, Application No. 73999/14, *Judgment*, 11 April 2017, para. 70; *Yegorychev v. Russia*, Application No. 8026/04, *Judgment*, 17 May 2016, para. 54; *Aleksandr Novikov v. Russia*, Application No. 7087/04, *Judgment*, 11 korrik 2013, para. 46. Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Šainović and Ojdanić Appeal Decision*, para. 6-7, 9-10; ICC, *Bemba et al. Appeal Judgment*, para. 111.

⁴² Ngjashëm, ICC/GJPN, *Lubanga Appeal Judgment*, para. 136-137.

⁴³ Vendim i apelit të Gucatit, para. 63; Ngjashëm, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-180-Red, *Decision on the "Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo"*, 13 July 2012, para. 62.

⁴⁴ *Shih* nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.

⁴⁵ Ngjashëm, ICTY/TPNJ, *Prlić et al. Appeal Decision*, para. 19-20.

⁴⁶ Ngjashëm, ICC/GJPN, *Gbagbo Appeal Judgment*, para. 63.

edhe, aq sa mund të parashikohet, kohën që i akuzuari pritët të kthehet për gjykim, nëse lirohet.⁴⁷

23. Në nenin 41(6)(b) të Ligjit renditen tri arsye të artikulueshme:

- (i) rreziku i arratisjes;
- (ii) rreziku i asgjësimit, fshehjes, ndryshimit ose falsifikimit të provave, ose i pengimit të ecursë së procesit nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit;
- (iii) rreziku i përsëritjes së veprës penale, i përfundimit të një veprë penale të tentuar, ose i kryerjes së një veprë penale që i akuzuari ka kërcënuar se do ta kryejë.

24. Në lidhje me arsyen e tretë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nuk ka nevojë që krimi i ardhshëm të jetë i njëjtë me krimet e përfshira në aktakuzë, apo të ndodhë në të njëjtin kontekst (i cili me gjasë nuk ekziston më) me atë për të cilin i akuzuari ndiqet penalisht. Përkundrazi, në bazë të informacionit të disponueshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të vlerësojë nëse ka gjasë që i akuzuari, nëse lirohet, do të përfshihet apo do të kontribuojë, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë, në krime të ngjashme me krimet bazë për të cilat akuzohet. Nuk ka nevojë për specifikim të hollësishëm të krimeve që parashikohet se do të kryhen në të ardhmen.⁴⁸

25. Në lidhje me arsyen e dytë dhe të tretë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se rreziqet mund të konkretizohen si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të të akuzuarit, por nuk është e nevojshme që i akuzuari t'i kryejë fizikisht ato.

⁴⁷ Ngjashëm, ICTY, [Šainović and Ojdanić Appeal Decision](#), para. 6-7; [Prlić et al. Appeal Decision](#), para. 7; [Lukić Appeal Decision](#), para. 7.

⁴⁸ ICC, [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 116; [Gbagbo Appeal Judgment](#), para. 70.

26. Për më tepër, të tri arsyet jepen si alternativa të njëra-tjetrës, dhe mjafton ekzistenca e njëres prej tyre për të përcaktuar domosdoshmërinë e paraburgimit të akuzuarit.⁴⁹

27. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund t'u referohet vendimeve të mëparshme dhe materialeve ose provave që i janë paraqitur, dhe kjo të mos ndikojë në natyrën *de novo* të vendimit aktual.⁵⁰

B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja kërkesën e vet e mbështet vetëm në pjesën e dytë të nenit 41(6) të Ligjit.⁵¹ Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta vlerësojë kërkesën vetëm përkundrejt rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.

1. Rreziku i arratisjes

29. Mbrojtja parashtroi se z. Veseli nuk përbën rrezik të identifikueshëm apo konkret arratisjeje, për shkak të: (i) mbështetjes së tij aktive për themelimin e DHS-së dhe bashkëpunimit me të, ndër të tjera edhe përmes një deklaratë publike pas dorëzimit të tij;⁵² (ii) pjesëmarrjes vullnetarisht në një intervistë me ZPS-në në Hagë, më 19 dhjetor 2019; dijenisë për ekzistencën e një aktakuze kundër tij që prej 23 qershorit 2020; faktit se para se të konfirmohej të aktakuza z. Veseli ofroi vetë të dorëzohej nëse aktakuza kundër tij do të konfirmohej; si dhe dorëzimit vullnetar

⁴⁹ Ngjashëm, ICC/GJPN, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 139; [Katanga Appeal Judgment](#), para. 20; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-321, Pre-Trial Chamber III, [Decision on Application for Interim Release](#), 16 December 2008, para. 35.

⁵⁰ Ngjashëm, ICC/GJPN, [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 60; [Gbagbo Appeal Judgment](#), para. 27, 69.

⁵¹ Kërkesa, para. 3-4, 6-51.

⁵² Kërkesa, para. 6-8 dhe referencat e përfshira aty; Shtojca 3 e kërkesës.

te ZPS-ja pas konfirmimit të aktakuzës;⁵³ dhe (iii) faktit se familja e z. Veseli, përfshirë fëmijët e tij të vegjël dhe prindërit e moshuar, jetojnë në Kosovë.⁵⁴

30. ZPS-ja përgjigjet se: (i) mundësia e një dënimi me burgim të gjatë, potencialisht edhe me burgim të përjetshëm, për krimet e paraqitura në Aktakuzë, bën që të ekzistojë rrezik i vazhdueshëm i arratisjes, i cili do të rritet pasi z. Veseli të njihet me tërësinë e provave kundër tij, që e tejkalon informacionin e përgjithshëm të paraqitur nga ZPS-ja në njoftimin e qershorit 2020;⁵⁵ (ii) mundësia e tij për të udhëtuar në disa vende në të cilat nuk mund të kapet nga DHS-ja dhe autoriteti, burimet dhe lidhjet e tij shtojnë më shumë rrezikun e arratisjes;⁵⁶ (iii) respektimi i fletarrestimit nga z. Veseli nuk ka vlerë pasi në atë kohë nuk kishte zgjedhje tjetër përveçse të dorëzohej;⁵⁷ (iv) si ish-shef i Shërbimit Informativ të Kosovës ("SHIK"), z. Veseli është një nga zyrtarët më me përvojë të zbulimit në Kosovë, dhe kjo, marrë së bashku me statusin e tij si figurë publike, tregon se ka njohuritë teknike dhe rrjetin për t'i ikur drejtësisë;⁵⁸ dhe (v) thirrjet publike të z. Veseli për të respektuar integritetin e procesit gjyqësor u bënë me qëllimin e qartë për të kërkuar lirim të përkohshëm, pasi lëvdatat e tij për DHS-në kanë qenë gjithnjë selektive dhe oportuniste, duke pasur parasysh se në të shkuarën ai e ka cilësuar DHS-në si një 'padrejtësi' dhe nuk është shprehur lidhur me orvatjet e fundit për pengim nga Organizata e Veteranëve të Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL-UÇK").⁵⁹

⁵³ Kërkesa, para. 6; KSC-BC-2020-06, F00024/A01, Prokurori i Specializuar, *Letër drejtuar Xhek Smith* ("Ofrimi për t'u dorëzuar"), 21 tetor 2020, publike.

⁵⁴ Kërkesa, para. 9.

⁵⁵ Përgjigja, para. 16, 19.

⁵⁶ Përgjigja, para. 18, 20.

⁵⁷ Përgjigja, para. 20.

⁵⁸ Përgjigja, para. 17.

⁵⁹ Përgjigja, para. 21-22 dhe referencat e përfshira aty.

31. Mbrojtja përgjigjet se: (i) paraburgimi nuk mund të përligjet dhe të zgjatet vetëm mbi bazën e peshës së akuzave dhe ashpërsisë së dënimeve të mundshme;⁶⁰ (ii) fakti që z. Veseli mund të ketë aftësinë të arratiset nuk nënkupton se do ta përdorë atë;⁶¹ (iii) nëse z. Veseli do të kishte ndër mend të arratisesh, do ta kishte bërë këtë midis qershorit dhe nëntorit 2020, kur mori dijeni për ekzistencën e aktakuzës kundër tij, në atë kohë ende të pakonfirmuar, për një numër vrasjesh si krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, pasi atëherë nuk i kufizohej liria e lëvizjes dhe mund të kishte shkuar në mënyrë të ligjshme në një shtet me të cilin Kosova nuk ka marrëveshje ekstradimi;⁶² (iv) fakti që është figurë e njohur publike, që do të thotë se mund të njihet lehtësisht, e ul mundësinë që t'ia dalë t'i shmanget drejtësisë;⁶³ (v) z. Veseli u këshillua posaçërisht nga Mbrojtja të mos jepte asnjë deklaratë publike lidhur me veprimet e OVL-UÇK -së në shtatorin e vitit 2020 dhe të distancohej nga organizata;⁶⁴ dhe (vi) nuk ka ndonjë konflikt mes mendimit se DHS-ja është një padrejtësi për Kosovën dhe pajtimin për të bashkëpunuar me të.⁶⁵

32. Sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranon argumentin e Mbrojtjes se, në kohën kur ZPS-ja bëri njoftimin në qershor 2020 lidhur me ekzistencën e një aktakuze kundër z. Veseli, ajo duhet ta ketë marrë parasysh se z. Veseli nuk përbënte rrezik të madh për t'u arratisur.⁶⁶ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se natyra dhe shkalla e krimeve për të cilat akuzohet, me të cilat është njohur gradualisht me anë të nxjerrjes së plotë të provave kundër të akuzuarve dhe me dhënien e informacionit më të zgjeruar nga ai që përmbahej në njoftimin e qershorit 2020 nga ZPS-ja, si dhe ashpërsia e dënimit të mundshëm,

⁶⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3-4.

⁶¹ Kundërpërgjigjja, para. 7.

⁶² Kundërpërgjigjja, para. 9, 48-49.

⁶³ Kundërpërgjigjja, para. 10.

⁶⁴ Kundërpërgjigjja, para. 19-20.

⁶⁵ Kundërpërgjigjja, para. 65-66.

⁶⁶ Kundërpërgjigjja, para. 49.

përbëjnë faktorë që do ta shtynin z. Veseli të arratiset në rast se do të lirohej. Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sjell në vëmendje se kundër z. Veseli është ngritur aktakuzë për 10 krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe se kuadri faktik i akuzave kundër tij përfshin mbi 40 vendndodhje në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore për një periudhë kohore prej një viti e gjysmë.⁶⁷ Nëse z. Veseli shpallet fajtor për disa, ose për të gjitha krimet për të cilat akuzohet, ai mund të dënohet për kohë të gjatë, përfshirë dënimin me burgim të përjetshëm sipas nenit 44(1) të Ligjit. Gjithashtu, ndikimi dhe autoriteti i z. Veseli si anëtar themelues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe shef i Drejtorisë së Shërbimit Informativ dhe shef i SHIK-ut,⁶⁸ dhe më rishtazi Kryetar i Kuvendit të Kosovës, nuk mund të mos merren parasysh gjatë vlerësimit të rrezikut, pasi individë që e përkrahin, përfshirë ish-vartësit dhe persona të tjerë që kanë lidhje me OVL-UÇK-në, mund të jenë të gatshëm t'i japin qasje në burime dhe/ose ta ndihmojnë të arratiset. Për më tepër, përvoja në zbulim dhe njohuritë, mundësitë dhe aftësitë e fituara⁶⁹ rrisin më shumë rrezikun e arratisjes.

33. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstaton se bashkëpunimi i z. Veseli me ZPS-në dhe DHS-në, si dhe përkrahja për themelimin e DHS-së janë faktorë të rëndësishëm. Rëndësi e posaçme i duhet kushtuar ofrimit të tij për t'u dorëzuar,⁷⁰ si dhe faktit se menjëherë pasi u vu në dijeni mbi ekzistencën e një fletarrestimi kundër tij, z. Veseli bëri një deklaratë ku inkurajonte bashkëpunimin me DHS-në.⁷¹ Nga pikëpamja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kjo nuk cenohet : (i) as nga cilësimi i DHS-së nga z. Veseli si "një padrejtësi që po bëhet në emër të drejtësisë";⁷² dhe (ii) as nga mosbërja e një deklarate publike lidhur me veprimet e

⁶⁷ KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e redaktuar më tej* ("Aktakuza"), 4 nëntor 2020, publike, para. 172-173.

⁶⁸ Vendimi i konfirmimit, para. 460.

⁶⁹ Përgjigjja, para. 17.

⁷⁰ Ofrimi për t'u dorëzuar; Kërkesa, para. 6; Kundërpërgjigja, para. 52.

⁷¹ Kërkesa, para. 6; Shtojca 3 e Kërkesës.

⁷² Përgjigjja, para. 22, poshtëshënimi 80 dhe referencat e përfshira aty.

shtatorit 2020 të ndërmarrë nga OVL-UÇK-ja.⁷³ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se këta faktorë, përfshirë shembujt e bashkëpunimit dhe respektimit të urdhrave të përmendur më lart, së bashku me lidhjet familjare të z. Veseli në Kosovë⁷⁴ dhe faktin që si figurë publike njihet më lehtë⁷⁵, vetëm e zvogëlojnë rrezikun e arratisjes së z. Veseli, por nuk e eliminojnë atë, pasi shumica e tyre i përkasin kohës para se të merrte dijëni për kuadrin e plotë të çështjes dhe provave kundër tij.

34. Lidhur me sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se: (i) mundësia e z. Veseli për shkuar në një numër vendesh ku nuk mund të kapet nga DHS-ja; (ii) statusi dhe figura e njohur publike e tij; dhe (iii) përvoja e gjerë në fushën e zbulimit, nëse vlerësohen sa i takon llojit dhe shkallës së akuzave të ngritura kundër tij dhe ashpërsisë së dënimit të mundshëm, peshojnë më shumë se rrethanat e parashtruara nga Mbrojtja.

35. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rreziku që z. Veseli të arratiset.

2. Rreziku i pengimit të procedurave të DHS-së

36. Mbrojtja argumenton se nuk ka arsye për të konstatuar se, nëse i akuzuari do të lirohej, ai do të pengonte administrimin e drejtësisë.⁷⁶ Mbrojtja thekson se z. Veseli në mënyrë aktive u ka bërë thirrje të gjithëve në Kosovë të respektojnë autoritetin e DHS-së dhe të bashkëpunojnë me organet e saj, dhe veçanërisht u ka bërë thirrje përkrahësve të tij të sigurojnë se nuk do të ketë orvatje për të ndërhyrë te dëshmitarët apo për të penguar hetimet.⁷⁷ Sa i takon gjashtë pretendimeve

⁷³ Përgjigjja, para. 22.

⁷⁴ Kërkesa, para. 9.

⁷⁵ Kundërpërgjigjja, para. 10.

⁷⁶ Kërkesa, para. 4, 12.

⁷⁷ Kërkesa, para. 12-13; Shtojca 3 e kërkesës.

konkrete të parashtruara në kërkesën e ZPS-së, për të cilat argumentohet se lidhen drejtpërdrejt me z. Veseli, Mbrojtja iu kundërpërgjigj atyre një nga një, duke argumentuar se pesë prej tyre nuk lidhen me të akuzuarin, ndërsa njëra syresh nuk duhet marrë parasysh prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shkak të redaktimeve të mëdha që i janë bërë.⁷⁸

37. ZPS-ja përgjigjet se thirrjet publike të z. Veseli për të respektuar integritetin e procesit gjyqësor dhe lëvdatat e tij për DHS-në qartazi janë bërë për të mbështetur kërkesën e tij për lirim të përkohshëm.⁷⁹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se pretendimet për pengim duhen parë në kuadër të përvojës së gjerë të z. Veseli në fushën e zbulimit dhe thekson se ndër detyrat e tij në shërbimin informativ, gjatë periudhës së akuzave, përfshihej dhe identifikimi dhe hetimi i personave të perceptuar si kundërshtarë.⁸⁰ ZPS-ja trajton edhe gjashtë pretendimet konkrete që kundërshtohen nga Mbrojtja.⁸¹

38. Mbrojtja në kundërpërgjigje kundërshton interpretimin e ZPS-së lidhur me thirrjet publike të z. Veseli për të respektuar DHS-në dhe vëren se ndikimi që deklarata e z. Veseli ka te përkrahësit e tij nuk varet nga mendimet apo qëllimet e tij personale.⁸² Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se, megjithëse përmendet posti i z. Veseli si shef i SHIK-ut për të mbështetur pretendimet lidhur me rrezikun për ndërhyrje të dëshmitarët, asnjë prej dokumenteve të cilëve u referohet ZPS-ja nuk përmban asnjë provë për veprimtari kriminale, dhe thekson se identifikimi i personave të perceptuar si kundërshtarë gjatë një konflikti të armatosur nuk është

⁷⁸ Kërkesa, para. 17-49.

⁷⁹ Përgjigja, para. 21-22 dhe referencat e përfshira aty.

⁸⁰ Përgjigja, para. 35 dhe referencat e përfshira aty.

⁸¹ Përgjigja, para. 27-40.

⁸² Kundërpërgjigja, para. 19-20, 63-66.

krim.⁸³ Mbrojtja u kundërpërgjigjet edhe parashtrimeve të ZPS-së në lidhje me gjashtë pretendimet konkrete, të cilat i kishte kundërshtuar fillimisht.⁸⁴

39. Lidhur me rrezikun për pengimin e procedurave të DHS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se postet me ndikim që z. Veseli ka pasur në të shkuarën dhe rishtas, sikurse përmenden në paragrafin 32 më lart, janë një faktor i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut. Nga pikëpamja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, autoriteti publik dhe postet me ndikim të z. Veseli, përfshirë postin si ish-oficer i zbulimit, i japin mundësi të ketë qasje në një rrjet përkrahësish dhe t'i mobilizojë ata, ndër të cilët edhe ish-vartës e persona që kanë lidhje me OVL-UÇK-në, me synimin për të penguar ecurinë e hetimeve të ZPS-së dhe pengimin e procedimit penal.⁸⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kjo është edhe më e vërtetë në këtë fazë të procesit, gjatë së cilës z. Veseli po informohet gradualisht për provat që konfirmojnë akuzat kundër tij, ku përfshihet identifikimi i dëshmitarëve të cilët kanë dhënë dëshmi ose mund të japin dëshmi për çështjen dhe/ose pritet të paraqiten para DHS-së. Megjithëse nxjerrja e identitetit të dëshmitarëve për të akuzuarit do të kryhet në mënyrë graduale, z. Veseli me kalimin e muajve do të ketë gjithnjë e më shumë qasje në provat dhe identitetin e dëshmitarëve të çështjes gjyqësore. Fakti se kur u dorëzua z. Veseli u bëri thirrje përkrahësve të siguronin se nuk do të kishte orvatje për të ndërhyrë te dëshmitarët ose për të penguar hetimet,⁸⁶ nuk e eliminon rrezikun që, nëse lirohet, ai ende mund të përdorë ndikimin e tij në mënyrat e lartpërmendura.

40. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh diskutimin e palëve për sa u takon disa pretendimeve lidhur me orvatjet e z. Veseli për të dëmtuar DHS-në dhe ZPS-në dhe për të ndërhyrë në hetime dhe procedura. Megjithëse përfshirja e të akuzuarit në një incident të caktuar mund të jetë tregues për synimet e tij të ardhshme,

⁸³ Kundërpërgjigjja, para. 8.

⁸⁴ Kundërpërgjigjja, para. 13-46.

⁸⁵ Përgjigjja, para. 24-26.

⁸⁶ Kërkesa, para. 12-13; Shtojca 3 e Kërkesës.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake para së gjithash duhet të përcaktojë nëse këto rrethana, të marra së bashku, përbëjnë rrezik për pengimin e ecursisë së procesit nga z. Veseli.

41. Para se të trajtojë rastet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të nevojshme të trajtojë parashtrimin e Mbrojtjes se redaktimet e shumta që janë bërë lidhur me një akuzë të caktuar në kërkesën e ZPS-së e pengojnë Mbrojtjen t'i përgjigjet në mënyrë të njëmendtë.⁸⁷ Lidhur me këtë pikë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se, duke pasur parasysh ndikimin që ka heqja e lirisë në të drejtat themelore të personit në fjalë, procedurat me anë të të cilave mund të ankimohet ligjshmëria e paraburgimit në parim duhet të përmbushin, për aq sa është e mundur, kriteret bazë për gjykim të drejtë, përfshirë të drejtën për proces ballafaques.⁸⁸ Megjithëse nevoja për të kryer hetime penale në mënyrë efikase mund të diktojë që një pjesë e informacionit të mbledhur të mbahet i fshehtë për të ruajtur integritetin e procesit dhe për të parandaluar falsifikimin e provave, ky qëllim legjitim nuk mund të arrihet duke i kufizuar ndjeshëm të drejtat e mbrojtjes. Për rrjedhojë, informacioni i domosdoshëm për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit i duhet vënë në dispozicion të paraburgosurit dhe mbrojtësve të tij/saj, në mënyrën e duhur.⁸⁹ Në rastin konkret, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se informacioni thelbësor lidhur me një incident në të cilin mbështetet ZPS-ja për të treguar ekzistencën e rrezikut për pengim të procesit nga z. Veseli është redaktuar⁹⁰ çka e pengon Mbrojtjen të kuptojë pretendimin bazë. Në këto kushte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e merr parasysh këtë pretendim për vlerësimin e ekzistencës së rrezikut për pengimin e procesit nga z. Veseli.⁹¹

⁸⁷ Kërkesa, para. 47-49; Kundërpërgjigja, para. 44-46.

⁸⁸ *Shih*, ECtHR, *Oravec v. Croatia*, Application no. 51249/11, [Judgment](#), 11 July 2017, para. 67.

⁸⁹ ECtHR, *Podeschi v. San Marino*, Application no. 66357/14, [Judgment](#), 13 April 2017, para. 176; *Albrechtas v. Lithuania*, Application no. 1886/06, [Judgment](#), 19 January 2016, para. 75; *Emilian-George Igna v. Romania*, Application no. 21249/05, [Judgment](#), 26 November 2013, para. 27.

⁹⁰ Kërkesa e ZPS-së, para. 15.

⁹¹ *Po ashtu*, megjithëse në tjetër kontekst, ICC, [Gbagbo 8 September 2015 Appeal Judgment](#), para. 87-88.

42. Sa i takon pretendimit për përfshirjen e z. Veseli në orvatjet për të shfuqizuar DHS-në me anë të miratimit të një projektligji në Parlamentin e Kosovës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se Partia Demokratike e Kosovës ("PDK"), e cila në atë kohë drejtohej nga z. Veseli, ishte ndër partitë që e mbështetën projektligjin.⁹² Sidoqoftë ai parashtroi më tej se z. Veseli e kundërshtoi miratimin e projektligjit pas reagimit të ashpër ndërkombëtar.⁹³ Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se ky pretendim nuk demonstroi ekzistencën e rrezikut për pengimin e procesit nga z. Veseli.

43. Lidhur me pozitën e mëparshme të z. Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se përvoja në zbulim, ndër të tjera edhe si shef i SHIK-ut, dhe njohuritë, mundësitë dhe aftësitë e fituara, shtojnë rrezikun e pengimit të ecures së procesit prej tij. Gjithashtu, në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se Gjykata Themelore Prishtinë u shpreh se ishte e mundshme që SHIK-u të ketë qenë i përfshirë në kryerjen e tri veprave penale, përkatësisht vrasje e rëndë, rrëmbim i mbetur në tentativë dhe vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, por gjykata nuk mundi të bënte konstatim jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me këtë.⁹⁴

44. Për sa i takon pretendimit për lidhjen e z. Veseli me Driton Lajcin ("z. Lajçi") dhe ndikimit tek ai, fillimisht Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranon argumentin e Mbrojtjes se ka mungesë provash që tregojnë se z. Veseli i ka kërkuar z. Lajçi të bëjë diçka të palejueshme.⁹⁵ Sidoqoftë, siç vërehet më lart, nuk kërkohet nga ZPS-ja të vërtetojë se z. Veseli ka penguar procedurat e DHS-së në të shkuarën, por se ekziston rreziku që mund ta bëjë.⁹⁶ Në këtë drejtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren: (i)

⁹² Kërkesa, para. 19; shtojcat 1 dhe 2 të Kërkesës; Përgjigjja, para. 37; Kundërpërgjigjja, para. 15; Shtojca 5 e Kundërpërgjigjes.

⁹³ Kërkesa, para. 18-22 dhe referencat e përfshira aty; shtojca 6 e Kërkesës; Përgjigjja, para. 38 dhe referencat e përfshira aty; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 21-22; Kundërpërgjigjja, para. 13-14, 16.

⁹⁴ Shtojca 4 e Kërkesës, f. 10-11, 56-57.

⁹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 30-33; Shtojca 2 e Kundërpërgjigjes, f. 1-3; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 9-10.

⁹⁶ *Shih më lart* para. 20.

anëtarësinë afatgjatë të z. Lajçi në PDK, parti që drejtohet nga z. Veseli;⁹⁷ (ii) faktin se në të shkuarën z. Lajçi ka shërbyer si këshilltar i z. Veseli;⁹⁸ dhe (iii) faktin se z. Lajçi merrte udhëzime prej z. Veseli.⁹⁹ Ai vëren më tej se z. Lajçi ka mbajtur postin e shefit të Divizionit për Koordinimin e Mbrojtjes Juridike dhe Mbështetjes Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara ("Divizioni"), post në të cilin ka qenë përgjegjës, ndër të tjera, për të siguruar përfaqësimin juridik të personave të thirrur nga ZPS-ja,¹⁰⁰ si dhe faktin se në të shkuarën z. Lajçi ka vepruar jashtë rolit të përmendur më lart, duke marrë pjesë në cilësinë e përkthyesit¹⁰¹ në një intervistë të ZPS-së me dëshmitar. Megjithatë ndërkohë z. Lajçi nuk është më shef i Divizionit,¹⁰² Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se praktika më lart tregon se z. Veseli mund t'i japë udhëzime një personi që ndërvepron me DHS-në. Ky është një argument i fuqishëm që tregon ekzistencën e rrezikut për pengim të procedurave të DHS-së nga z. Veseli.

45. Për sa u përket pretendimeve lidhur me orvatjet nga Qeveria e Kosovës për të ushtruar ndikim të palejueshëm mbi dëshmitarë të mundshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje pagesën prej 40.000 eurosh që i është bërë Lahi Brahimajt nga Qeveria e Kosovës ("z. Brahimaj") para intervistës së tij me ZPS-në.¹⁰³ Duke pasur parasysh pagesat që u janë bërë tre personave të tjerë të thirrur nga ZPS-ja, përkatësisht në shumat 13.000 euro, 10.000 euro, dhe 7.000 euro,¹⁰⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pagesa e z. Brahimaj ishte joproporcionale në krahasim me të tjerat. Për më tepër fakti që z. Brahimaj rrezikonte seriozisht të ndiqej

⁹⁷ Përgjigjja, para. 30.

⁹⁸ Përgjigjja, para. 30; Shtojca 1 e Përgjigjes, p. 9.

⁹⁹ Përgjigjja, para. 31; Shtojca 1 e Përgjigjes, p. 12.

¹⁰⁰ Kërkesa, para. 28; Shtojca 5 e Kërkesës; Kundërpërgjigjja, para. 30; Shtojca 2 e Kundërpërgjigjes, f. 1-2; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 9.

¹⁰¹ Kërkesa, para. 29-31, 33; Shtojca 5 e Kërkesës; Kundërpërgjigjja, para. 31; Shtojca 2 e Kundërpërgjigjes, f. 1-2; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 9-10.

¹⁰² Shtojca 5 e Kërkesës; Shtojca 2 e Kundërpërgjigjes, f. 1.

¹⁰³ Kërkesa, para. 36, 38; Kundërpërgjigjja, para. 24.

¹⁰⁴ Kundërpërgjigjja, para. 23; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 13.

penalisht për shkak të rolit dhe anëtarësisë së tij në UÇK¹⁰⁵, nuk është shpjegim për madhësinë e pagesës që iu bë dhe thekson se procesi me anë të të cilit u miratua pagesa nuk kërkonte përmbushjen e ndonjë kriteri të veçantë dhe as dorëzimin e faturave.¹⁰⁶

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu edhe emërimin e Syleman Selimit ("z. Selimi") si këshilltar i Kryeministrit të Kosovës pak kohë pasi ishte thirrur nga ZPS-ja për intervistë.¹⁰⁷ Fakti se si emërimi i z. Selimi, ashtu edhe thirrja për intervistë e tij, ndodhën pak kohë pas lirimit të tij nga burgu¹⁰⁸ nuk shpjegon pse z. Selimi, i cili ishte mbajtur në paraburgim për akuza lidhur me krime lufte të kryera në qendrën e ndalimit në Likoc¹⁰⁹, u emërua në pozicion të lartë qeveritar në të njëjtën kohë, ose rreth së njëjtës kohë kur pati dhe intervistën me ZPS-në.

47. Dy shembujt e lartpërmendur, që kanë të bëjnë me z. Brahimaj dhe z. Selimi, megjithëse nuk e përfshijnë drejtpërdrejt z. Veseli,¹¹⁰ tregojnë se në Qeverinë e Kosovës, e cila në atë kohë mbështetej nga z. Veseli si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe nga grupi parlamentar i PDK-së, në atë periudhë ekzistonte një atmosferë orvatjesh për ndërhyrje në hetimet e ZPS-së dhe procedurat e DHS-së. Në gjykimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kjo shton më tej rrezikun e pengimit të procesit nga z. Veseli.

48. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se konstatimet e lartpërmendura duhet të vendosen në kontekstin e një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme frikësimi të dëshmitarëve dhe ndërhyrjesh në proceset penale kundër ish pjesëtarëve të UÇK-së.¹¹¹ Ndonëse rreziku i pengimit të procesit

¹⁰⁵ Kundërpërgjigjja, para. 25-26; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 18; Shtojca 7 e Kundërpërgjigjes, para. 5-7.

¹⁰⁶ Kundërpërgjigjja, para. 24; Shtojca 6 e Kundërpërgjigjes, para. 6-7, 14-19; Shtojca 12 e Kundërpërgjigjes.

¹⁰⁷ Kërkesa, para. 43; Përgjigjja, para. 34.

¹⁰⁸ Kërkesa, para. 44-45; Kundërpërgjigjja, para. 35, 37.

¹⁰⁹ Përgjigjja, para. 34.

¹¹⁰ Kërkesa, para. 37, 46.

¹¹¹ Vendimi mbi arrestimin dhe paraburgimin, para. 41; KSC-BC-2020-06, F00005/RED, Prokurori i Specializuar, *Versioni publik i redaktuar i "Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to", parashtrimi*

penal nuk përcaktohet vetëm nga ky fakt, ai përbën një argument të cilit Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur, së bashku me faktorët e tjerë të trajtuar më lart.

49. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekziston rreziku se z. Veseli do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

50. Mbrojtja parashtrohet se nuk ekziston asnjë rrezik për përsëritjen e krimeve të pretenduara në aktakuzën kundër z. Veseli, të cilat lidheshin tërësisht vetëm me kontekstin e një konflikti të armatosur që po zhvillohej, dhe sikurse demonstroi Mbrojtja, pretendimet e ZPS-së lidhur me rrezikun e supozuar për pengim të drejtësisë janë të pabaza.¹¹² Duke qenë se ZPS-ja nuk ka paraqitur arsye të artikulueshme se pse beson që, z. Veseli ka gjasa të kryejë krime të tjera nëse i miratohet lirimi i përkohshëm, atëherë ajo nuk mund të paraqesë kundërshtim për miratimin e lirit të përkohshëm mbi këtë bazë.¹¹³

51. ZPS-ja përgjigjet se ekziston ende rreziku që z. Veseli të kryejë krime të tjera për arsye të: (i) natyrës së ndërmarrjes kriminale të përbashkët, për të cilën akuzohet, që ka të bëjë me shënjestrimin e kundërshtarëve të të akuzuarve; (ii) orvatjeve të z. Veseli për të penguar ecurinë e procesit penal; dhe (iii) atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.¹¹⁴ Më tej ajo parashtrohet se, megjithëse Mbrojtja përpiqet të mbështetet tek koha që ka kaluar nga kryerja e veprave penale të pretenduara, dyshimi i bazuar mirë se z. Veseli ka kryer një varg krimesh lufte dhe krimesh kundër njerëzimit është një tregues

KSC-BC-2020-06/F00005, datë 28 maj 2020, 17 nëntor 2020, publik, para. 18-26, 34-35, 40, me Shtojcat 1-3, publike .

¹¹² Kërkesa, para. 50-51.

¹¹³ Kërkesa, para. 50-51.

¹¹⁴ Përgjigjja, para. 41-42.

serioz, ndër të tjera, i rrezikut se ai është i gatshëm të kryejë akte të tjera dhune, edhe pas shumë vitesh.¹¹⁵

52. Sa i takon rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton edhe një herë konstatimin e lartpërmendur se ekziston rreziku që z. Veseli do të pengojë procedurat e DHS-së.¹¹⁶ Ndonëse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procedurave nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se natyra e rëndë e krimeve për të cilat akuzohet z. Veseli dhe rreziku se do të përfshihet në pengimin e drejtësisë, sikurse përcaktohet më lart, duhen marrë parasysh së bashku me pozitën e rëndësishëm që ka pasur z. Veseli në Kosovë dhe në kuadër të praktikës së përhapur të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes tek ata në proceset gjyqësore kundër ish-anëtarëve të UÇK-së.¹¹⁷ Të gjithë këta faktorë, të marrë së bashku, tregojnë se ekziston rreziku se z. Veseli, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë, do të përfshihet në kryerjen ose do të kryejë krime të ngjashme me krimet bazë për të cilat akuzohet, kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen edhe dëshmitarët që kanë i dhënë dëshmi ZPS-së dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Një kontribut i tillë nuk ka nevojë të konkretizohet përmes kryerjes së këtyre krimeve personalisht nga z. Veseli. Mjafton që përmes deklaratave të tij, qoftë publike apo private, z. Veseli mund të nxisë apo ndihmojë individë në rrjetin e tij mbështetës që të kryejnë krime të tilla, apo të kontribuojë në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e tyre.

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht konstaton se ekziston rreziku që z. Veseli të kryejë krime të tjera.

¹¹⁵ Përgjigjja, para. 43.

¹¹⁶ *Shih më lart* para. 49.

¹¹⁷ *Shih më lart* para. 48.

4. Përfundim

54. Gjykatësi i Procedurës Paraprake del në përfundimin se ka rrezik që z. Veseli të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, apo të kryejë krime të tjera kundër personave që pretendojnë se pjesëtarët e UÇK-së kanë kryer krime, përfshirë dëshmitarët që i kanë dhënë dëshmi ZPS-së dhe/ose që pritët të dëshmojnë përpara DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse kushtet e propozuara mund të trajtojnë në mënyrën e duhur këto rreziqe.

C. KUSHTET E PROPOZUARA

55. Mbrojtja parashtrohet se, edhe nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se ZPS-ja e ka përmbushur detyrimin për të vërtetuar se ka arsye të artikulueshme për të besuar ekzistencën e ndonjë prej kritereve të parapara në nenin 41(6) të Ligjit, ai përsëri duhet ta miratojë lirimin e përkohshëm me kusht, përveç nëse ZPS-ja është në gjendje të vërtetojë se: (i) paraburgimi në pritje të gjykimit është masa më pak kufizuese që ka në dispozicion për përmbushjen e qëllimit të saj dhe se të gjitha masat e tjera të parapara në nenin 41(12) të Ligjit janë të pamjaftueshme për të trajtuar rreziqet që ekzistojnë; dhe (ii) paraburgimi në pritje të gjykimit, në këto rrethana, është një kufizim proporcional mbi supozimin e lirisë dhe të pafajësisë.¹¹⁸ Më tej Mbrojtja shtjellon se z. Veseli është i gatshëm të zbatojë çdo masë për zvogëlimin e rrezikut ku përfshihen, ndër të tjera: (i) mospërfshirja në asnjë veprimtari politike publike dhe mosbërja e deklaratave të tjera pa miratimin paraprak të ZPS-së ose Gjykatësit të Procedurës Paraprake; (ii) arrest shtëpiak në banesën e familjes së tij në Prishtinë; (iii) dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit; (iv) moskontaktimi i dëshmitarëve të mundshëm,

¹¹⁸ Kërkesa, para. 59-62 dhe referencat e përfshira aty.

qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi; dhe (v) monitorim nga afër, ndër të tjera edhe përmes vizitave dhe kontrolleve rastësore pa paralajmërim në shtëpi dhe/ose verifikimet të rregullta të përditshme nga EULEX-i në Kosovë (“kushtet e propozuara”).¹¹⁹ Lidhur me kohëzgjatjen e pritshme të paraburgimit, Mbrojtja parashtron se, duke pasur parasysh shtrirjen e çështjes dhe numrin e dëshmitarëve që pritet të thirren nga ZPS-ja, si dhe duke e krahasuar me çështje të ngjashme në TPNJ, pritet që paraburgimi të zgjasë të paktën deri në qershor 2022.¹²⁰

56. ZPS-ja përgjigjet se asnjë kombinim i kushteve e propozuara nuk do t'i zvogëlonte rreziqet që paraqet z. Veseli nëse lirohet¹²¹ dhe se paraburgimi në objektin e paraburgimit të DHS-së, me kornizën përkatëse të monitorimit të komunikimeve që zbatohet aty, është i vetmi mjet për menaxhimin e këtyre rreziqeve.¹²² ZPS argumenton më tej se as ZPS-ja, as EULEX-i dhe as Policia e Kosovës nuk i kanë mjetet dhe burimet për të monitoruar siç duhet një të akuzuar me ndikimin, autoritetin dhe burimet e z. Veseli.¹²³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se parashikimi i Mbrojtjes për kohëzgjatjen e pritshme të procedurës paraprake është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me interesin e drejtësisë.¹²⁴ Edhe sikur përlllogaritjet e paraqitura të merren për të mirëqena, kjo nuk do të thotë se kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim në pritje të gjykimit, në bazë të atyre përlllogaritjeve, është e paarsyeshme.¹²⁵ Sidoqoftë, në këtë fazë të procesit ky vlerësim është tërësisht hipotetik dhe nuk ndikon aspak në rishikimin e paraburgimit sipas rregullës 57 të Rregullores nga Gjykatësi i Procedurës

¹¹⁹ Kërkesa, para. 10.

¹²⁰ Kërkesa, para. 63-68.

¹²¹ Përgjigjja, para. 44.

¹²² Përgjigjja, para. 44.

¹²³ Përgjigjja, para. 45-46.

¹²⁴ Përgjigjja, para. 9.

¹²⁵ Përgjigjja, para. 10.

Paraprake, veçanërisht në kushtet kur korniza ligjore parashikon rivlerësimin dhe rishikimin e masës së paraburgimit çdo dy muaj.¹²⁶

57. Mbrojtja kundërpërgjigjet se: (i) në rast se zotit Veseli i miratohet lirimi i përkohshëm me kushte, ndër të cilat dorëzimi i pasaportës dhe ndalimi i udhëtimit, ai nuk do të ketë asnjë mënyrë që të arratiset në një vend që nuk ka marrëveshje ekstradimi me Kosovën;¹²⁷ (ii) fakti se z. Veseli u përmend me emër si person për të cilin ishte ngritur aktakuzë në qershor 2020, i vendos një barrë jashtëzakonisht të madhe ZPS-së të shpjegojë pse – për arsye të diçkaje të ndodhur prej atëherë dhe që krijon një rrezik i cili nuk ekzistonte në atë kohë – lirimi i përkohshëm me kushte të rrepta përbën nivel të papranueshëm rreziku, kur qartazi nuk përbënte rrezik mes qershorit dhe nëntorit 2020;¹²⁸ (iii) Mbrojtja ka marrë informacion nga Shërbimi i Policisë së Kosovës dhe nga Ministria e Drejtësisë që tregon se Policia e Kosovës ka kapacitetet të monitorojë dhe të zbatojë kushtet për lirim të përkohshëm të vendosura nga DHS-ja si dhe të garantojë pjesëmarrjen e të akuzuarit në gjyq, çka duhet të favorizojë fuqishëm miratimin e lirit me kusht, madje edhe në rastet kur organet përgjegjëse ligjzbatuese nuk janë në gjendje të ofrojnë garanci të plotë për respektimin e masave;¹²⁹ dhe (iv) vlerësimi kohëzgjatjes së pritshme të paraburgimit është i detyrueshëm gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim të përkohshëm.¹³⁰

58. Lidhur me rrezikun e arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara mund t'i zvogëlojnë rreziqet në lidhje me z. Veseli. Në këtë drejtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson në mënyrë të favorshme kushtet e propozuara për arrestin shtëpiak të z. Veseli në shtëpinë e tij në Prishtinë, dorëzimin e dokumenteve të udhëtimit dhe ndalimin e udhëtimit.

¹²⁶ Përgjigjja, para. 8, 10.

¹²⁷ Kundërpërgjigjja, para. 12.

¹²⁸ Kundërpërgjigjja, para. 49-51.

¹²⁹ Kundërpërgjigjja, para. 55-61; Shtojca 9-11 e Kundërpërgjigjes.

¹³⁰ Kundërpërgjigjja, para. 69-72.

59. Lidhur me rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së ose kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se asnjë prej kushteve të propozuara, dhe as kufizime shtesë të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk do të mund ta kufizonin mundësinë e z. Veseli për të komunikuar përmes mjeteve jopublike me komunitetin ose rrjetin e tij përkrahës. Pikërisht përmes këtij komunikimi, z. Veseli mund të nxisë, ndihmojë apo ndryshe, të angazhojë të tjerët në frikësimin apo dëmtimin e atyre personave që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së. Kufizimi i lëvizjeve apo veprimtarisë publike të z. Veseli nuk do t'ia kufizonte atij mundësinë për të komunikuar në mënyrë private nga shtëpia. Ajo çka është më e rëndësishme, ndalimi i z. Veseli nga kontaktimi i dëshmitarëve, personave të lidhur me këtë çështje apo, qoftë edhe çdo person në Kosovë, as nuk mund të realizohet, e as të monitorohet, pavarësisht nëse një ndalim i tillë ka të bëjë me kontakte personale apo është komunikim përmes mjeteve elektronike. Komunikimet e z. Veseli mund të kufizohen dhe monitorohen me efektivitet vetëm me anë të kornizës së monitorimit që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së, duke zvogëluar kështu rreziqet që ai të pengojë procedurat e DHS-së, apo të përfshihet ose kontribuojë në krime.

60. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht konstaton se kushtet e propozuara, ku përfshihet edhe çfarëdo kufizimesh shtesë të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk do t'i zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procedurave të DHS-së apo të kryerjes së krimeve të tjera.

61. Në lidhje me proporcionalitetin e paraburgimit, është detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të marrë parasysh masat më të buta kur vendos nëse një person duhet mbajtur në paraburgim.¹³¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se në rrethanat e çështjes në fjalë, rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit

¹³¹ KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj 2020, publik, para. 70; Vendimi i apelit të Gucatit, para. 72.*

nuk mund të zvogëlohen përmes kushteve të propozuara. Duke pasur parasysh këta faktorë dhe se për z. Veseli janë ngritur 10 akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit,¹³² për të cilat mund të dënohet me burgim të gjatë e deri me burgim të përjetshëm,¹³³ dhe se ai u arrestua më 5 nëntor 2020,¹³⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në këtë fazë çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen e gjithsejtë të paraburgimit paraprak të z. Veseli është i parakohshëm dhe hamendësues.

V. KËRKESA PËR SEANCË

62. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, megjithëse sipas kornizës ligjore disa seanca lidhur me aspekte të caktuara janë absolutisht të domosdoshme, në raste të tjera Rregullorja lejon që mbajtja e seancave t'i lihet diskrecionit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, posaçërisht nëse është e nevojshme për të mundësuar procedime të drejta dhe të shpejta, sikurse përcaktohet në rregullën 95(2)(d) të Rregullores.¹³⁵

63. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se ai ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme të bëheshin parashtrime gojore lidhur me mbajtjen në paraburgim ose lirimin e të akuzuarit, duke pasur parasysh parashtrimet e shumta dhe shteruese me shkrim nga Mbrojtja në lidhje me të.¹³⁶ Tashmë argumentet janë shtjelluar edhe më tej në përgjigje dhe kundërpërgjigje. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se për qëllimet e këtij vendimi, nuk nevojitet vlerësimi i besueshmërisë së provave të dëshmitarëve të Mbrojtjes. Në këto kushte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se seanca nuk është e domosdoshme.

¹³² Aktakuza, para. 172-173.

¹³³ Neni 44(1) i Ligjit.

¹³⁴ KSC-BC-2020-06, F00050, Administratorja, *Njoftim për arrestimin e Kadri Veselit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

¹³⁵ Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit, para. 18.

¹³⁶ Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit, para. 19.

VI. VENDIM

64. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **REFUZON** kërkesën;
- b. **REFUZON** kërkesën e Mbrojtjes për seancë;
- c. **MIRATON** kërkesën për riklasifikim; dhe
- d. **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë F00151 (pa shtojcat) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 22 janar 2021

Në Hagë, Holandë